

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	611-23-12208-1-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	LETAMED shpk
NUI	812046276
Adresa	Nebih Hodo Kuci
Vendi	SUHAREKE
Kodi postar	23000
Numri Telefonit	049541344
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Arjanit Bytyqi
Adresa elektronike	
Data e parashtrimit të kërkesës	19.12.2023

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Procedura është hapur me date: 03.11.2023

AK me date 15.12.2023 ka publikuar B58

Me date: 18.12.2023 kemi kerkuar qasje ne dokumente zyrtare te cilen qasje AK nuk na ka ofruar konform LPP-se

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 11 Informatat Sekrete Afariste

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

AK me date: 15.12.2023 na ka derguar njoftim vendimin B58 dhe Letren standarde si ten derues i pa sukseshem.

Pasi kemi analizuar vendimin e AK te dates 15.12.2023, dhe duke marr parasysh faktin se AK ka propozuar per kontrate nje OE te pa pergjegjshem, kemi kerkuar qasje ne dokumente zyrtare dhe AK na ka ftuar per qasje me date 18.12.2023.

Por qasja nuk na eshte ofruar konform LPP-se, sepse OE I rekomanduar , ne ANEKS 3 te Dosjes së Tenderit ka specifikuar kerkesa te cilat nuk duhet te jene sekret afarist që është në kundërshtim me nenin 11 të LPP-së, ndersa AK konform kerkeses jo ligjore te OE te rekomanduar nuk na ka ofruar deshmite e kerkuara. Po ashtu ne kemi kërkuar dëshmitë e OE për këtë aktivitet të prokurimit, qka nënkupton se është dashur të na jep edhe ofertën e OE NARABIOTIKS shpk, por një gjë të tillë nuk e ka bërë AK dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 11 të LPP-së.

Me OE te rekomanduar ne kemi nje pervoje te ngjajshme ne disa Autoritete Kontraktuese, sepse i njejti ngase nuk i ploteson kerkesat e FDT-se per tu mbrojtur nga ajo qe nuk ka deshmite e kerkuara me FDT, e ben kerkesen per sekret afarist dhe AK duke u mbeshtetur ne kete dokument, e rekomandojne per fitues edhe pse i njejti nuk i ploteson kerkesat e FDT-se respektivisht kërkesat e nenin 69 të LPP-së.

OE i rekomanduar, perkunder qe AK nuk na ka ofruar qasje, por ne e njohim si konkurent dhe ne disa AK (si shembull ne AK Komuna Rahovec) kemi patur qasje ne oferten e ketij OE dhe ky OE te cilin ju e keni propozuar per kontrate, ka ofruar edhe per ju, Autorizimin nga prodhuesi nga nje PRODHUES tjetër, ndersa Certifikatat ISO dhe CE si dhe IEC i ka te nje Prodhuesi tjetër dhe nuk kanë lidhmëri me OE të rekomanduar.

Po ashtu ky OE për këtë aktivitet të prokurimit në Dosjen e Tenderit ka bërë ankesë në OSHP sa i përket certifikatës IEC, qka nënkupton se OE i rekomanduar nga ana e juaj, nuk ka certifikatë IEC të kërkuar me Dosje të Tenderit në pikën: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 3 Certifikata IEC.

Pra nese ju e beni vleresimin konform nenit 59 te LPP-se, do ta vereni se AUTORIZIMI, KATALOGU dhe Certifikatat ISO se bashku me CE dhe IEC nuk perputhen sepse jane te prodhuesve te ndryshem dhe nuk kanë të bëjnë me këtë Operator Ekonomik. Vlerësimi I bërë dhe Vendimi I datës 15.12.2023 janë në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së.

Pra AK Komuna e Drenasit ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 te LPP-se dhe ka vepruar ne kundërshtim me nenin Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, sepse ka rekomanduar per kontrate nje OE te pa pergjegjshem dhe me vendimin e dates 15.12.2023 ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe Rregulloren për prokurim publik 001/2022.

Po ashtu AK Komuna e Dransit ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së ku OE NARABIOTIKS SHPK, e ka vlerësuar si OE i përgjegjshëm, sepse i njëjti është biznes I ri dhe nuk ka kontrata dhe referenca të natyrës së kërkuar me FDT. Respektivisht ky OE nuk i ka plotësuar kërkesat e FDT-së konform nenit 69 të LPP-së.

Kerkojme nga ZPP i AK qe te aprovoje kerkesen per RISHQYRTIM dhe te ktheje lenden ne RIVLERESIM duke na shpallur neve fitues si OE i pergjegjshem qe kemi plotesuar te gjitha kerkesat e FDT-se dhe me çmimin me te ulet ne kete procedure siq kërkohet me nenin 1 të LPP-së:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Me kete vendim AK na ka demtuar ne aspektin financiar sepse ne tashme si OE i pergjegjshem kemi bere shpenzime gjate pergaditjes se DT e poashtu me kete vendim jemi detyruar te angazhojme staf shtese per te shqyrtuar pretendimet per kete procedure.

Nje demtim tjeter eshte edhe ne aspektin moral te kompanise sepse keni propozuar

nje OE te pa pergjegjshe ndersa na keni eleminuar neve si OE qe i kemi plotesuar te gjitha kerkesat e FDT-se.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*